



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____ 2021

VENDIM
Nr. 527, datë 10.11.2021

PËR
VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES (
, PËR VITIN 2019

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 85, 89 dhe 95, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares Ornela Naqellari, për vitin 2019”, i hartuar nga relatore znj. Brunilda Kadi,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares _____, për vitin 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI


1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtares në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtares bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtares pikëzohet sipas dy treguesve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1-A Njohuritë ligjore.

1-A-a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Nga vëzhgimi i procesverbaleve të seancave gjyqësore, në çështjet e përzgjedhura me short, evidentohet se gjyqtarja ka njohje dhe zbatim korrekt të ligjit material civil dhe penal, si dhe dispozitave procedurale të referuara në mbështetje të vendimeve të ndërmjetme, gjatë zhvillimit të seancave dhe në përfundim të tyre.



Nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit konstatohet se gjyqtarja, përcakton qartë faktet dhe më pas natyrën e çështjes objekt shqyrtimi, duke përcaktuar shkakun ligjor të padisë, natyrën e mosmarrëveshjes me karakter civil, penal, civil-familjar, kërkesë civile, etj. Gjyqtarja, pasi bën përcaktimin e saktë të natyrës së çështjes, identifikon dhe argumenton çështjet thelbësore objekt gjykimi, të cilat shërbejnë për zgjidhjen e çështjes.

Në lidhje me përcaktimin e ligjit të zbatueshëm, gjyqtarja evidenton qartë ligjin, duke cituar të gjitha dispozitat ligjore, materiale apo procedurale, që gjejnë zbatim në çështjet objekt gjykimi. Në fillim të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimeve përfundimtare, gjyqtarja përcakton të gjithë procedurën gjyqësore të ndjekur për çështjen konkrete. Përpara shqyrtimit të bazueshmërisë në ligj dhe në prova të padisë, gjyqtarja analizon kryesisht juridiksionin dhe kompetencën e gjykatës për shqyrtimin e çështjes, duke referuar dhe cituar bazën ligjore përkatëse. Kur është rasti ka parashtruar edhe elementë të tjerë procedural dhe i ka arsyetuar duke cituar dhe interpretuar ligjin procedural në lidhje me kërkesat për sigurim padie, ndryshim objekt padie, dispozitat për afatet e veprimeve procedurale. Në çështjet penale parashtron historikun procedural, duke cituar dhe interpretuar dispozitat procedurale penale të zbatueshme në rastin në shqyrtim.


Në vijim, gjyqtarja paraqet në mënyrë të përmbledhur, në çështjet civile, pretendimet dhe prapësimet e palëve, në çështjet penale kërkesat, argumentet dhe qëndrimet palëve, duke vijuar më pas me faktet e çështjes, të cilat kanë rezultuar të provuara nga provat e administruara gjatë gjykimit. Gjyqtarja, pasi përshkruan faktet e çështjes, duke përshkruar provat përkatëse prej të cilave rezultojnë ato, vijon me analizën juridike të çështjes. Në këtë pjesë të vendimit, gjyqtarja analizon rrethanat e faktit, duke i ndërthurur me provat shkresore të marra në shqyrtim dhe ligjin e zbatueshëm për zgjidhjen e çështjes.

Në lidhje me konfliktin e normave, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, konstatohet vetëm në një rast, e konkretisht te vendimi i zgjedhur nga vetë gjyqtarja, që i përket çështjes penale, me nr. vendimi 267, dt 19.11.2019.

Në tërësi, referuar të dhënave që evidentohen nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, vlerësohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve dhe më pas të natyrës së çështjes, identifikimit të normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim mbi secilin fakt, citimin dhe analizën e normave respektive, në të cilat është bazuar vendimi i dhënë nga Gjykata.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarja për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 25 pikë.

1-A-b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.



Nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit konstatohet se gjyqtarja, referon, citon dhe interpreton normat e ligjit procedural dhe material të zbatueshëm mbi faktet e çështjes, në shërbim të analizës ligjore dhe zbatimit të tyre në zgjidhjen e çështjes konkrete.

Gjyqtarja në çdo vendim citon normat ligjore në një nënndarje të posaçme të pjesës arsyetuese të titulluar “Analiza juridike”, duke i shoqëruar me interpretimin dhe aplikimin e tyre mbi faktet e çështjes konkrete. Në pjesën vijuese të arsyetimit, bëhet vlerësimi i gjykatës mbi bazueshmërinë në ligj dhe në prova të kërkimeve objekt padie/kërkesë apo objektit të çështjes penale.

Përveç citimit, gjyqtarja bën një analizë ligjore dhe interpretim të kuptimit të dispozitave të caktuara të ligjit procedural dhe material që gjejnë zbatim mbi faktin. Ky interpretim, në vendimet e vëzhguara, ndërthuret drejtpërdrejtë mbi provat dhe faktet e provuara prej tyre. Analiza ligjore përbën një rrjedhë logjike midis fakteve, interpretimit të ligjit, aplikimit të tij mbi faktin konkret dhe konkluzioneve të arritura.

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, në çdo rast janë respektuar me korrektësi aspektet e parimit të procesit të rregullt ligjor, parimin e interesit më të lartë të fëmijës, parimin e ligjit penal favorizues, parimin sipas të cilit çdo dyshim lidhur me akuzën shkon në favor të të pandehurit dhe se fajësia duhet të vërtetohet “*përtej çdo dyshimi të arsyeshëm*”.

Konkretisht, në 8 vendimet përfundimtare të vëzhguara, evidentohet se gjyqtarja analizon dhe interpreton; *të drejtën e të miturit për t'u dëgjuar në një procedurë gjyqësore, referuar nenit 6 të K. Familjes dhe nenit 12 të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, zbaton nenin 2 të K. Familjes, i cili referon parimin e interesit më të lartë të fëmijës, analizon mënyrën e zbatimit të neneve 2, 5, 6, 155, 157, 224, 228, 265, 267, 270 dhe 272 të K. Familjes, si dhe nenit 59 të ligjit nr. 18/2017 mbi faktet objekt gjykimi, zhvillon analizën juridike të nenit 296 të K. Civil, padisë së rivendikimit, duke evidentuar kuptimin dhe subjektet e legjitimuara aktivisht dhe pasivisht në të, zhvillon analizën juridike të nenit 608 të K. Civil, duke evidentuar katër kushtet e shpërblimit të dëmit jashtëkontraktor; kundërligjshmëria e veprimeve; ekzistenca e dëmit pasuror; lidhja shkakësore; faji, analizon zbatimin e nenit 608 të K. Civil në faktet e çështjes objekt gjykimi, analizon se verifikohet zbatimi i nenit 510/a të K. Pr. Civile dhe ligjit nr. 9662 datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, si dhe gjejnë zbatim nenet 5-6 të ligjit nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, analizon veprën penale parashikuar nga neni 96 i K. Penal, duke evidentuar elementët e saj, analizon konceptin e gabimit mjekësor, trajton parimin e ligjit penal favorizues, duke evidentuar dispozitat ligjore ku ai gjen parashikim (neni 29/3 i Kushtetutës dhe neni 3 i K. Penal), jurisprudencën e Gjykatës së Lartë, përkatësisht vendimi unifikues nr. 4 datë 27.03.2003, si dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, përkatësisht vendimi nr. 14 datë 17.04.2007, trajton parimin sipas të cilit çdo dyshim lidhur me akuzën shkon në favor të të pandehurit dhe se fajësia duhet të vërtetohet “*përtej çdo dyshimi të arsyeshëm*”. Në këtë kuadër sjell në vëmendje vendimin unifikues nr. 7 datë 14.10.2011, analizon elementët që i shërbejnë individualizimit të dënimit, analizon*

mënyrën e zbatimit të nenit 96, 47, 48, 49, 59, 60, 30 dhe 35 të K. Penal, si dhe të parimeve të trajtuara në faktet objekt gjykimi, analizon mënyrën e zbatimit të neneve 132 dhe 146/1 të K. Familjes mbi faktet objekt gjykimi, analizon qëllimin e neneve 332/a dhe 332/c të K. Pr. Penale në raport me nenet 128, 129 dhe 151 të K. Pr. Penale, analizon rastet e pavlefshmërisë absolute sipas nenit 128/a të K. Pr. Penale dhe rastet e pavlefshmërisë relative sipas nenit 129 të K. Pr. Penale mbi faktet objekt gjykimi, evidenton jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut (pa cituar ndonjë vendim konkret) sipas së cilës vlerësohet në tërësi procedura dhe ndikimi i shkeljes në mohimin apo cenimin e procesit të rregullt, citon jurisprudencën e Gjykatës së Lartë, përkatësisht vendimin nr. 00-2011-132-14, datë 26.01.2011 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, analizon zbatimin e neneve 179 dhe 181/1 të K. Pr. Penale në çështjen objekt gjykimi, analizon nenet 324-325 të K. Pr. Penale dhe më pas verifikon zbatimin e tyre në çështjen objekt gjykimi, analizon nenin 13 të K. Penal, si dhe konceptet "Conditio sine qua non/kushti pa të cilin" dhe "Kushti determinant", analizon zbatimin e nenit 328/dh të K. Pr. Penale në çështjen objekt gjykimi, analizon kuptimin dhe qëllimin e afateve të parashkrimit, analizon se verifikohet zbatimi i nenit 66/ç të K. Penal, si dhe neneve 328/1/d dhe 329/a të K. Pr. Penale".

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, vlerësohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë për të interpretuar ligjin në funksion të zgjidhjes së çështjes. Në vendimet përfundimtare të analizuara, gjyqtarja ka interpretuar dispozita të akteve ligjore dhe nënligjore, me natyrë procedurale dhe materiale, duke referuar edhe në jurisprudencën relevante të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 25 pikë.

I-B Arsyetimi ligjor

I-B-a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Vendimet gjyqësore të vëzhguara të gjyqtares janë të organizuara sipas një strukture të qartë dhe standardizuar ; pjesa hyrëse, arsyetuese, dispozitivi. Në pjesën hyrëse vendimet përmbajnë elementët e nevojshëm në lidhje me përcaktimin e gjykatës, përbërjen e trupit gjykues, kohës së zhvillimit të gjykimit, të dhënat e plota të palëve, dhe përfaqësuesve të tyre, objektin dhe bazën ligjore si dhe kërkimet përfundimtare të palëve, të përmbledhura në një fjali. Pjesa përshkruese arsyetuese, është e organizuar sipas një strukture të standardizuar me nënndarje, ku fillimisht në një nënndarje të titulluar "Procedura gjyqësore", trajtohet e gjithë procedura e ndjekur nga gjykata, që nga paraqitja e kërkesë padisë, duke trajtuar çështje të veçanta si juridiksionin gjyqësor dhe kompetencën, apo të kërkesave procedurale të paraqitura nga palët gjatë gjykimit. Më pas, gjyqtarja paraqet në mënyrë të përmbledhur pretendimet e palës paditëse gjatë gjykimit dhe prapësimet e palës së paditur. Në vijim, në një nënndarje të veçantë të titulluar "rrethanat e çështjes", përshkruhen rrethanat e faktit, duke i integruar me provat prej të cilave rezultojnë ato. Arsyetimi vazhdon me një nënndarje

të veçantë të titulluar “analiza juridike”, në të cilën përcaktohet ligji i zbatueshëm dhe vlerësimi i gjykatës se si ligji zbatohet mbi faktet objekt gjykimi. Dispozitivi i vendimeve është i plotë i qartë dhe konkret. Në veprimet për drejtimin e seancave gjyqësore dhe vendimet përfundimtare, përdoret një gjuhë e thjeshtë, e qartë dhe e drejtpërdrejtë.

Gjyqtarja përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, respekton rregullat gramatikore dhe ato të sintaksës, duke i bërë vendimet të qarta dhe të shkruara në mënyrë korrekte në aspektin gjuhësor. Ndonjëherë, përdor shprehje latine, përgjithësisht shoqëruar me kuptimin e tyre në gjuhën shqipe. Fjalitë ndërtohen në mënyrë të tillë që të transmetojë mendimin dhe të lidhen me njëra-tjetrën nga vijimësia e kuptimit. Teksti i vendimeve është i organizuar në paragrafë, të cilët lidhen me njëri-tjetrin përmes kronologjisë së mendimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e Lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

I-B-b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit.

Gjyqtarja i harton vendimet e tij me strukturë të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar. Vendimet e vëzhguara respektojnë me rigorozitet strukturën formale me tre pjesë të vendimit, por edhe elementët e çdo pjese, siç përcakton neni 310 i Kodit të Procedurës Civile dhe neni 383 i Kodit të Procedurës Penale. Çdo vendim gjyqësor përmban pjesën hyrëse, pjesën përshkuese-arsyetuese, si dhe dispozitivin.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënave të regjistrimit dhe gjykata që ka gjykuar çështjen, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët, objekti i shqyrtimit dhe baza ligjore, si dhe kërkimet përfundimtare të palëve të pranishme në proces.

Në pjesën përshkuese-arsyetuese gjejnë pasqyrim në mënyrë të strukturuar procedura e ndjekur, pretendimet dhe prapësimet e palëve në mënyrë të përmbledhur, faktet e çështjes siç rezultojnë nga provat, ligji i zbatueshëm dhe vlerësimi i gjykatës, ku merret në analizë ligji i zbatueshëm, elementët e tij në lidhje me faktet konkrete, dhe në fund konkluzioni i gjyqtarës për zgjidhjen e çështjes.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës për zgjidhjen e çështjes, shpenzimet gjyqësore, si dhe e drejta e ankimit. Përsa i takon dispozitivit të vendimit, gjyqtarja përdor teknikën e listimit të disponimeve duke i numërtuar ato, që lehtëson referencat në rastin kur vendimi ka disa disponime. Struktura e vendimit dhe nënndarjet, janë në harmoni me njëra - tjetrën dhe në rrjedhë logjike në shërbim të konkluzioneve të arritura në vendim. Pjesa urdhëruese e vendimit është e qartë, koncize, e thjeshtë dhe e kuptueshme.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.



I-B-c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Në vendimet gjyqësore të vëzhguara konstatohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në drejtim të analizës dhe argumentimit logjik. Gjyqtarja, identifikon dispozitat ligjore, shtjellon argumentat e gjykatës në mënyrë logjike, duke paraqitur një analizë të plotë të fakteve të çështjes, së bashku me provat mbi të cilat ato mbështeten, si dhe paraqet argumentat në lidhje me bazueshmërinë ose jo të kërkimeve objekt gjykimi.

Në vendimet gjyqësore të vëzhguara evidentohet: *analiza që i bëhet legjitimitimit procedural të kërkuesit referuar nenit 264 të K. Familjes dhe ligjit nr. 18/2017, kujdestarisë dhe përkujdesjes alternative të përkohshme të fëmijës së mitur, analiza e nenit 270 të K. Familjes, legjitimitimi aktiv i kërkuesit në bazë të nenit 511 të K. Pr. Civile, analiza e rrethanave konkrete sipas të cilave vlerësohet se nuk ka më kuptim vazhdimi i mëtejshëm i martesës, analiza e mënyrës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, zbatimi i nenit 146/1 të K. Familjes, kuptimi dhe elementët e dëmin pasuror jashtëkontraktor dhe shpërblimit të tij, analiza e nenit 296 të K. Civil, kuptimin dhe subjektet e legjitimuar sipas tij, analiza e nenit 96 të K. Penal dhe përmbajtjen e dispozitës së ndryshuar gjatë kohës së gjykimit të çështjes duke analizuar edhe zbatimin e ligjit penal favorizues, dallimi i pakujdesisë që sjell përgjegjësi penale me gabimin mjekësor, në caktimin e masës së dënimit analiza e rrezikshmërisë së veprës penale, pasoja e ardhur prej saj, shkalla e fajësisë, normalizimi i marrëdhënieve me të dëmtuarit, si dhe rrethanat të tjera të jetës personale të të pandehurit, analizoha e pranimit të kërkesës për aplikimin e nenit 59 të K. Penal, aplikimi i dënimit plotësues, analiza e mjaftueshmërisë së provave të paraqitura nga akuza për dërgimin e çështjes penale në gjyq, përdorshmëria e provave dhe vlefshmëria e akteve, theksohet dallimi ndërmjet “Kushtit pa të cilin” dhe “Kushtit determinant”, analiza e kuptimit dhe qëllimit të afateve të parashkrimit, si dhe veprimi i parimit të ligjshmërisë.*

Gjyqtarja argumenton në mënyrë logjike lidhjen e fakteve të provuara në gjykim, me ligjin e zbatueshëm, kuptimin e tij nëpërmjet interpretimit dhe duke identifikuar lidhjen shkak-pasojë, mes faktit, ligjit dhe konkluzionit në zgjidhjen e çështjes. Përveç paraqitjes së analizës së plotë të fakteve të çështjes, duke referuar në provat mbi të cilat ato mbështeten, faktet të caktuara dhe me rëndësi në raport me argumentet e gjykatës, rimerren në analizë, në mënyrë të integruar me analizën e ligjit, në pjesën e arsytimit të vendimit.

Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë, duke marrë në analizë dhe duke i dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve ndërgjyqëse.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.



KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarës në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A Aftësia e gjyqtarës për të përballuar ngarkesën në punë.

2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja ka gjykuar në total 85 çështje për të cilat ligji ka parashikuar afate gjykimi, nga të cilat 23 jashtë afatit. Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (23 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (85 çështje), gjyqtari rezulton që të ketë gjykuar 27 % të çështjeve jashtë afatit ligjor.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit, gjyqtarja shpjegon se ; *Nga analiza e të dhënave statistikore rezulton që vetëm 23 çështje janë përfunduar tej afatit ligjor nga 369 në total, pra 6%. Në këtë formular gjyqtarja jep shpjegime për arsyet e kapërcimit të këtyre afateve, por në përgjithësi, jo për çështjet konkrete të gjykuara jashtë afateve ligjore.*

Në lidhje me shpjegimet e gjyqtarës për këtë tregues, duhet të qartësohet fillimisht se, vlerësimi i saj që ka gjykuar jashtë afateve ligjore, vetëm 6% të çështjeve, është i gabuar. Si edhe shpjegohet, qartë dhe logjikisht, në metodologjinë e miratuar nga Këshilli, përqindja e çështjeve të gjykuara jashtë afatit ligjor, nuk llogaritet në raport më të gjitha çështje të gjykuara, siç e ka llogaritur gjyqtarja. Kjo përqindje llogaritet si raport mes këtyre çështjeve dhe vetëm atyre për të cilat ligji parashikon afate, e që sipas statistikave janë 85 dhe jo 369. Kjo përqindje dhe ky raport, si edhe është shpjeguar në raportin analitik, është 27 % dhe jo 6 %. Për të vlerësuar këtë tregues, sipas metodologjisë së miratuar nga Këshilli, këto të dhëna statistikore duhet të analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarës. Respektimi i këtyre afateve, jo gjithmonë është i varur nga gjyqtarja. Konkretisht, duke analizuar 23 çështjet, të cilat rezultojnë se janë gjykuar përtej afatit ligjor, evidentohet se ;

1. çështja me nr. rendor 12, në tabelën nr. 10, me objekt "Revokim mase sigurimi", është gjykuar në afatin 7 ditë, 2 ditë më tepër nga afati ligjor 5 ditor dhe data e shortit, 13.09.2019, është ditë e premte.

2. çështjet me nr. rendor 24, 29 dhe 30, në tabelën nr. 10, me objekt "Ankim kundër vendimit të mosfillimit të procedurës penale", janë gjykuar përkatësisht në afatin 1 muaj e 4 ditë, 1 muaj e 2 ditë dhe 1 muaj e 5 ditë, që do të thotë vetëm 4, 2 dhe 5 ditë më tepër nga afati ligjor 30 ditë.

3. çështjet me nr. rendor 18, 42, dhe 54, në tabelën nr. 11, me objekt "Dërgim çështje në gjyq", të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatet, 1 muaj e 1 ditë, 1 muaj e 6 ditë, dhe 1 muaj e 5 ditë, që do të thotë vetëm 4, 2 dhe 5 ditë më tepër nga afati ligjor 30 ditë.

Duke marrë parasysh edhe ;

a) përjashtimin nga kjo periudhë, kohën që mund të ketë marrë lëvizja e dosjes nga momenti i regjistrimit deri te shortimi dhe dorëzimi te gjyqtarja,

b) kohën që i është dashur gjyqtares për shtyrje të gjykimit për shkaqe të pavarura prej saj si është njoftimi dhe respektimi i të drejtave të tjera të palëve,

c) ngarkesën e gjyqtares gjatë periudhës së vlerësimit. nga ku rezulton se ajo ka gjykuar disa herë më shumë se numri i çështjeve, sipas standardit minimal sasior të punës, të përcaktuar në vendimin nr. 261/2, dt 14.04.2010, të KLD-së, dhe

d) diferencën e vogël në kohë nga afati ligjor,

konsiderohet se këto 7 çështje janë gjykuar brenda afatit ligjor.

Nisur nga analiza e mësipërme, rezulton përfundimisht se gjyqtarja ka gjykuar jashtë afatit ligjor, vetëm 16 nga 23 çështjet e analizuar, në total 16 nga 85 çështjet për të cilat ligji ka parashikuar afat ligjor, ose 18.8 % të tyre.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet "Mbi mesatare", duke e pikëzuar me 12 pikë.

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja ka gjykuar në total 284 çështje për të cilat janë parashikuar afate orientuese për standardin minimal, prej të cilave 43 çështje jashtë afatit standard minimal kohor, ose 15 % e tyre.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit, gjyqtarja shpjegon se: "Nga analiza e të dhënave statistikore rezulton se vetëm 43 çështje janë përfunduar tej afatit ligjor nga 369 çështje të përfunduara në total, pra 12%. Në vijim ajo analizon dhe justifikon afatet e gjykimit për 10 nga këto 43 çështje.

Në lidhje me shpjegimet e gjyqtares për këtë tregues, duhet të qartësohet fillimisht se, vlerësimi i saj që ka gjykuar jashtë afatit standard minimal kohor, vetëm 12% të çështjeve, është i gabuar. Si edhe shpjegohet, qartë dhe logjikisht, në metodologjinë e miratuar nga Këshilli, përqindja e çështjeve të gjykuara jashtë afatit standard minimal kohor, nuk llogaritet në raport më të gjitha çështje te gjykuara, siç e ka llogaritur gjyqtarja. Kjo përqindje llogaritet si raport mes këtyre çështjeve dhe vetëm atyre për të cilat aktet nënligjore

parashikojnë këto afate, e që sipas statistikave janë 284 dhe jo 369. Kjo përqindje dhe ky raport, si edhe është shpjeguar në raportin analitik, është 15 % dhe jo 12 %.

Për të vlerësuar këtë tregues, sipas metodologjisë së miratuar nga Këshilli, këto të dhëna statistikore duhet të analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarës. Respektimi i këtyre afateve, jo gjithmonë është i varur nga gjyqtarja. Konkretisht, duke analizuar 43 çështjet, të cilat rezultojnë se janë gjykuar përtej afatit standard minimal kohor, evidentohet se:

1. çështjet me nr. rendor 13 dhe 14, në tabelën nr. 1, janë gjykuar përkatësisht në afatin 6 muaj e 13 ditë dhe 6 muaj e 21 ditë, pra 13 dhe 21 ditë më tepër se afati 6 muaj. Referuar periudhës së gjykimit, rezulton se gjatë saj përfshihet muaji Gusht, brenda të cilit minimalisht 3 javë duhet të përjashtohen për shkak të lejes vjetore që merret nga gjyqtarët.
2. çështja me nr. rendor 101, në tabelën nr. 2, është gjykuar në afatin 2 muaj e 7 ditë, pra 7 ditë jashtë afatit dhe në këtë periudhë përfshihet muaji Gusht.
3. çështjet me nr. rendor 23, 26, në tabelën nr. 3, me objekt "Zgjidhje martese", të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatin 4 muaj e 3 ditë, 4 muaj e 3 ditë (brenda të cilës përfshihet edhe muaji Gusht), pra vetëm 3 ditë jashtë afatit standard minimal prej 4 muaj.
4. çështja me nr. rendor 3, në tabelën nr. 4, është gjykuar në afatin 2 muaj e 10 ditë (brenda të cilës përfshihet edhe muaji Gusht), pra 10 ditë jashtë afatit.
5. çështja me nr. rendor 2, në tabelën nr. 7, është gjykuar në afatin 7 muaj, pra një muaj jashtë afatit 6 muaj, dhe në këtë periudhë përfshihet muaji Gusht.
6. çështjet me nr. rendor 19, dhe 41, në tabelën nr. 11, janë gjykuar përkatësisht në afatin 2 muaj e 6 ditë dhe 2 muaj e 4 ditë, pra vetëm 6 dhe 4 ditë jashtë afatit standard minimal prej 2 muaj.
7. çështjet me nr. rendor 23 dhe 33 dhe 34, në tabelën nr. 12, janë gjykuar përkatësisht në afatin 2 muaj e 8 ditë, 2 muaj e 8 ditë (brenda të cilës përfshihet edhe muaji Gusht) dhe 2 muaj e 4 ditë, pra vetëm 8 dhe 4 ditë jashtë afatit standard minimal prej 2 muaj.

Duke marrë parasysh edhe ;

- a) arsyetimin e justifikimit të kalimit të këtij afati për 10 çështje, nga vetë gjyqtarja sipas Formularit të Integruar të Vlerësimit
- b) përjashtimin nga kjo periudhë, kohën që mund të ketë marrë lëvizja e dosjes nga momenti i regjistrimit deri te shortimi dhe dorëzimi te gjyqtari
- c) kohën që i është dashur gjyqtarës për shtyrje të gjykimit për shkaqe të pavarura prej saj si është njoftimi dhe respektimi i të drejtave të tjera të palëve
- c) ngarkesën e gjyqtarës gjatë periudhës së vlerësimit, nga ku rezulton se ajo ka gjykuar *disa herë më shumë* se numri i çështjeve, sipas standardit minimal sasior të punës, të përcaktuar në vendimin nr. 261/2, dt 14.04.2010, të KLD-së, dhe
- d) diferencën e vogël në kohë nga afati standard minimal kohor, konsiderohet se këto 22 çështje janë gjykuar brenda këtij afati.

Nisur nga analiza e mësipërme, rezulton përfundimisht se gjyqtarja ka gjykuar jashtë afatit të standardit minimal kohor, vetëm 21 nga 43 çështjet e analizuar, në total 21 nga 284

çështjet për të cilat janë parashikuar afate orientuese për standardin minimal, ose 7.4 % të tyre.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar, për shumicën e kategorive e të çështjeve. Sipas raportit analitik, rezulton se për 2 nga 10 kategoritë e çështjeve, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, koha mesatare është më e gjatë se standardi minimal kohor, përkatësisht; për kategorinë e çështjeve “civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, koha mesatare, rezulton të jetë 254 ditë, pra më e gjatë se standardi minimal kohor i miratuar prej gjashtë muajsh, dhe për kategorinë e çështjeve “familjare pa palë kundërshtare”, koha mesatare rezulton të jetë 90 ditë, pra më e gjatë se standardi minimal kohor i miratuar, prej dy muajsh.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit, gjyqtarja, lidhur me këtë tregues ka renditur një sërë shkaqesh që ndikojnë në kohëzgjatjen e gjykimeve tej standardevë minimale kohore si: *“Kujdesi për të mos cenuar kontradiktorialitetin, mbrojtjen efektive, garantimin e hetimit të plotë dhe të gjithanshëm për zgjidhjen e drejtë të çështjes, cilësinë e gjykimit dhe të drejtën për proces të rregullt ligjor, ngarkesën e çështjeve (gjithsej 369) të përfunduara në vitin 2019, ngarkesa shumë e lartë për shkak të drejtimit të gjykatës, në cilësinë e kryetares së gjykatës (një pjesë e detyrave të përshkruara në analizën vjetore të performancës së gjykatës për vitin 2019), shqyrtimi gjatë këtij viti i 125 kërkesave për heqje dorë nga gjykimi i gjyqtarëve”*.

Duke analizuar të dhënat statistikore për çdo çështje, nga kjo periudhë duhet të zbriten:

a) koha që i është dashur gjyqtarës për shtyrje të gjykimit për shkaqe të pavarura prej tij si ; *njoftimi dhe respektimi i të drejtave të tjera të palëve, pushimet vjetore gjatë muajit Gusht, festat zyrtare* b) koha që mund të ketë marrë lëvizja e dosjes nga momenti i regjistrimit deri te shortimi dhe dorëzimi te gjyqtari. Gjithashtu, në këtë analizë duhet patur parasysh edhe: a) fakti që janë vetëm 2 nga 10 kategori dhe b) ngarkesën e gjyqtarës gjatë periudhës së vlerësimit, nga ku rezulton se ajo ka gjykuar *disa herë më shumë* se numri i çështjeve, sipas standardit minimal sasior të punës, të përcaktuar në vendimin nr. 261/2, datë 14.04.2010, të KLD-së. Nisur nga kjo analizë, vlerësohet që koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, është më e shkurtër se standardi minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve dhe për këtë arsye, gjyqtarja për këtë tregues vlerësohet në nivelin maksimal.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore nga gjyqtarja është 110 %.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

2.A.d Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor nga ana e gjyqtares, është më e shkurtër se afati procedural, për shumicën e kategorive të çështjeve.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit, gjyqtarja, lidhur me këtë tregues ka renditur një sërë shkaqesh që kanë ndikuar në kohën mesatare të arsyetimit të vendimit si; *“Përpyjekjet maksimale për të arsyetuar në kohë sa më të shpejtë vendimet gjyqësore, duke u kujdesur në të njëjtën kohë për të mos cenuar cilësinë e arsyetimit të vendimit. Përveç ngarkesës me çështje, gjithsej 369 të përfunduara në vitin 2019, të merret parasysh edhe ngarkesa shumë e lartë në punë, për shkak të drejtimit të gjykatës, në cilësinë e kryetares së gjykatës (një pjesë e detyrave të përshkruara në analizën vjetore të performancës së gjykatës për vitin 2019), shqyrtimi gjatë këtij viti i 125 kërkesave për heqje dorë nga gjykimi të gjyqtarëve. Gjithashtu, se përsa i përket disa rasteve, kjo ka ardhur si pasojë e përfundimit të afatit ligjor të arsyetimit dhe dorëzimit të vendimit në ditë pushimi, dhe rrjedhimisht dorëzimin e vendimit, ditën e parë pasardhëse të punës.”*. Ndërkohë gjyqtarja nuk ka dhënë shpjegim konkret për asnjë nga çështjet, duke e bërë të pamundur këtë analizë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues vlerësohet “Mbi mesataren”, duke e pikëzuar me 12 pikë.

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh (duke përfshirur ato pa palë ndërgjyqëse) është 2.8 dhe nga ana e gjyqtares janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Referuar; a) analizës së çështjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, nga të cilat evidentohet se; *gjyqtarja në të gjitha çështjet e ka vënë në lëvizje dosjen në kohë dhe në përputhje me afatet ligjore, ka kryer veprimet procedurale të nevojshme si: për kryerjen e veprimeve paraprake, për kryerjen e veprimeve përgatitore efektive dhe në kohë, njoftimin e akteve palës së paditur, deklaratën e mbrojtjes palës paditëse, planifikimi dhe zhvillimi i seancave përgatitore efektive për caktimin e seancës së pajtimit, për shqyrtimin e kërkesës për sigurim padie në kohë, për kryerjen e të gjitha veprimeve procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor të dokumentuara në dosje, drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt dhe është shprehur me urdhra dhe vendime të ndërmjetme për çdo kërkesë të palëve ndërgjyqëse, ndjek me rigorozitet të gjitha fazat në të cilat kalon shqyrtimi gjyqësor, seancat kanë filluar në përgjithësi pa vonesë, dhe në ato raste në të cilat ka pasur vonesa, është relatuar gjithmonë arsyeja, seancat gjyqësore janë të regjistruara audio dhe b) burimeve të tjera të vlerësimit, evidentohet se nga ana e gjyqtares janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.*

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 20 pikë.

2.C Aftësia e gjyqtares për të administruar dosjen gjyqësore.

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se nga ana e gjyqtares renditja e akteve të dosjes gjyqësore është në atë mënyrë që e bën dosjen lehtësisht të shfrytëzueshme.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet që dokumentacioni në dosje, është në përputhje me veprimet procedurale të kryera, nuk ka mungesa, dhe se është i duhuri.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
94	Shkëlqyeshëm

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A Etika në punë

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Referuar burimeve të vlerësimit, **nuk** evidentohet të ketë të dhëna që mund të tregojnë cenim të etikës apo përgjegjshmërisë në ushtrimin e funksionit, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim, mungesë vetëpërmbytje, ndjeshmërie, vëmendje, apo praninë e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtares, gjatë ushtrimit të funksionit.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e etikës së gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 35 pikë.

3.B Integriteti i gjyqtares

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti.

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të integritetit si dhe **nuk** rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjelle që cenojnë nderin dhe dinjitetin e saj.

Shkalla e integritetit të gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e integritetit të gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 40 pikë.



3.C Paanësia e gjyqtares

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese

Referuar burimeve të vlerësimit, **nuk** rezulton që gjyqtarja, të ketë përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit si dhe në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për periudhën e vlerësimit 01.01.2019–31.12.2019, janë paraqitur 4 kërkesa për përjashtimin e gjyqtares, por vetëm 1 kërkesë është pranuar. Po kështu, rezulton se edhe vetë gjyqtarja ka paraqitur 8 kërkesa për heqje dorë, të cilat janë pranuar. Për këto arsye, për këtë tregues numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares, vlerësohet si “i pakonsiderueshëm”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

KRITERI	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtares në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A Aftësia e komunikimit.

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka komunikim të qartë dhe transparent, me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares në këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Referuar burimeve të vlerësimit, **nuk** rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve, apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, gjyqtarja në këtë tregues, vlerësohet në nivelin “Shumë i lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B Aftësia për të bashkëpunuar

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, prezumohet se ajo ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares në këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me administratën gjyqësore, prezumohet se ajo ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares në këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 10 pikë.

4.C Gatishmëria e gjyqtares për t'u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtares në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja gjatë vitit 2019, ka marrë pjesë në programet e formimit vazhdues e konkretisht; Në cilësinë e pjesëmarrësit në 1 trajnim 1 ditor, në cilësinë e lehtësuesit në 5 trajnime përgjatë 9 ditëve dhe në cilësinë e ekspertit në 1 trajnim përgjatë 2 ditëve.

Duke iu referuar nenit 55, pika 9 të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës, pjesëmarrja në programimin e trajnimit vazhdues në cilësinë e trajnerit ose lehtësuesit ka vlerë edhe për efekt të përmbushjes së detyrimit për ndjekjen e programit të trajnimit vazhdues duke u përlloritur 1 ditë pjesëmarrje si trajner, e barabartë me 2.5 ditë si pjesëmarrës dhe 1 ditë pjesëmarrje si lehtësues me 2 ditë si pjesëmarrës, ndërsa në cilësinë e ekspertit 1 ditë pjesëmarrje është i barabartë me 2.5 ditë pjesëmarrje në trajnim. Sa më sipër, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë, gjatë periudhës një vjeçare të vlerësimit në 7 aktivitete trajnuese të cilat përbëjnë 24 ditë trajnimi. Kjo kohëzgjatje është brenda kufijve 5 deri në 40 ditë, në periudhën një vjeçare të vlerësimit.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues, gjyqtarja vlerësohet me 20 pikë.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja gjatë vitit 2019, ka marrë pjesë me cilësinë e ekspertes, në 1 trajnim, gjithsej 5 ditë si dhe në cilësinë e lehtësueses, në 5 trajnime, gjithsej 18 ditë.

Disponueshmëria e gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues gjyqtarja, vlerësohet me 5 pikë.

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari të marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se për periudhën e vlerësimit, gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitetit si më poshtë vijojnë;
-Trajnimin e trajnerëve. Zhvillimi i kurrikulës dhe metodologjitë e mësimdhënies, Dubrovnik, Kroaci, më 24-26 Shtator 2019.

-Pjesëmarrëse në Trajnimin “Menaxhimi i gjykatave”, organizuar nga EJTN, mbështetur nga OSCE, Projekti “Drejtësi pa vonesa”, Paris, Francë, më 2-4 Dhjetor 2019.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarës dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues, gjyqtarja vlerësohet me 5 pikë.

4.C.ç Publikimet ligjore akademike.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, si dhe akteve të paraqitura nga gjyqtarja së bashku me kundërshtimet lidhur me këtë tregues, evidentohet se gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtarja ka realizuar dy publikime ligjore akademike me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinës, si më poshtë:

- Bashkëautore në Modulën “Menaxhimi i lëvizjes së çështjeve”, hartuar në kuadër të Programit të Formimit Fillestar të kandidatëve për kancelarë në gjykata, pranë Shkollës së Magjistraturës, përfunduar në vitin 2019;
- Bashkëautore e “Udhëzuesit për menaxhimin aktiv të çështjeve gjyqësore”, hartuar në kuadër të Projektit “Drejtësi pa vonesa”, batuar në dhjetor 2019.

Angazhimi i gjyqtarës dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues, gjyqtarja vlerësohet me 5 pikë.

KRITERI	
AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarës	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarës	94	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	100	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	394	Shkëlqyeshëm

PROPOZIME DHE REKOMANDIME

Bazuar në nenin 93 pika 5 shkronja “ç” të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuara dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandohet nga Këshilli që gjyqtarja të vazhdojë të angazhohet në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit në këto fusha.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

SHTOJCA I

KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE NIVELI I VLERËSIMIT, PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 01.01.2019-31.12.2019 I GJYQTARES



1. AFTËSITË PROFESIONALE			Pikët total	Niveli i vlerësimit
			100	Shkëlqyeshëm
Treguesit	Burimet	Shkalla e aftësisë	Pikët	Të dhëna për metodologjinë
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarët 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarët 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtarët: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë

	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarët 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarëve 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtarëve: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
B. Arsyetimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarët 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarëve 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	15	Shkalla e aftësisë së gjyqtarëve: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarët 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarëve 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtarëve: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarët 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarëve 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtarëve: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë

1. AFTËSITË ORGANIZATIVE				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				94	Shkëlqyeshëm
Tregues	Burimet	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia	
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Mbi mesatare	12	Jashtë afatit: Mbi 40 % - 3 pikë 31-40 % - 6 pikë 21-30 % - 9 pikë 11-20 % - 12 pikë 0-10 % - 15 pikë
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	5	Jashtë afatit: Mbi 40 % - 1 pikë 31-40 % - 2 pikë 21-30 % - 3 pikë 11-20 % - 4 pikë 0-10 % - 5 pikë
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	5	Koha mesatare: Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë

					<p>Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë</p> <p>Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë</p> <p>Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve – 5 pikë</p>
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	<p>1. Të dhënat statistikore</p> <p>2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit</p> <p>3. Mendimi përfundimtar i kryetarit</p>	Shumë e lartë	10	<p>Tej standardit :</p> <p>Nën 81 %- 2 pikë</p> <p>Mbi 81-87 % - 4 pikë</p> <p>Mbi 87- 93 % - 6 pikë</p> <p>Mbi 93-99 % - 8 pikë</p> <p>+99% - 10 pikë</p>
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	<p>1. Të dhënat statistikore</p> <p>2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit</p> <p>3. Mendimi përfundimtar i kryetarit</p>	Mbi mesatare	12	<p>Koha mesatare:</p> <p>Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë</p> <p>Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë</p> <p>Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9 pikë</p> <p>Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e</p>

					kategorive të çështjeve- 12 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 15 pikë
B. Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedural gjyqësore	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	1. Të dhënat statistikore/aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	15	Numri mesatar i seancave dhe shkalla e aftësisë së gjyqtarit: Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë 1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	20	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 4 pikë Nën mesataren – 8 pikë Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë Shumë e lartë - 20 pikë
C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	5	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë

					Mbi mesataren – 4 pikë Shumë e lartë - 5 pikë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë
3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				100	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 4. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	35	Shkalla e etikës në punë e gjyqtarit: E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë
B. Integriteti i gjyqtarit	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	1. Informacioni i marrë nga ILD	Shumë e lartë	40	Shkalla e integritetit të gjyqtarit :



		2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 4. Të dhënat e raportit të ILDKPKI			E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë	
C. Paanësia e gjyqtrit	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	1. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 2. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim	Shumë e lartë	10	Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë	
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Nuk ka asnjë kërkesë të pranuar të palëve për përjashtim gjyqtari	15	Numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit: Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë	
4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL					Pikët total	Niveli i vlerësimit
					100	Shkëlqyeshëm

Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	Shumë e lartë	25	Qartësia dhe transparencja e komunikimit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	I Lartë	15	Respektimi i konfidencialitetit: I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	15	Shkalla e komunikimit: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë

	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	10	Shkalla e komunikimit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
C. Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Dokumente të dorëzuara nga gjyqtari	Mbi 5 ditë (për periudhën 1 vjeçare)	20	Pjesëmarrja e gjyqtarit: (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4
	b. Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	c. Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Dosja personale e gjyqtarit 4. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të gjyqtarit	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë

	ç. Publikimi ligjore akademike	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të tij	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë
PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT			394		
NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT			Shkëlqyeshëm		



RELATOR